

Numri i dosjes: **KSC-BC-2020-06**
Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendos: **Gjykatësi i Procedurës Paraprake**
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi parashtrues: Mbrojtësi i Rexhep Selimit

Data: 17 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publike

Parashtrimet e Mbrojtjes për konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes

Prokurori i Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësi i Hashim Thaçit
Dejvid Hupër

Mbrojtësi i Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësi i Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtësja e Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

I. HYRJE

1. Në përputhje me Urdhrin për konferencën mbi ecurinë e çështjes,¹ Mbrojtja për z. Rexhep Selimi paraqet parashtrimet me shkrim në lidhje me pikat e rendit të ditës të caktuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,² dhe çështjet e lidhura me to.³

II. PARASHTRIME

A. Pyetje të përgjithshme

1. Hetimet e Prokurorisë

2. Që në fillim, Mbrojtja vë në dukje me shqetësim se duket se Prokurori i Specializuar (“ZPS”) është duke planifikuar “një numër hapash hetimorë”⁴ pas konfirmimit të Aktakuzës në këtë çështje dhe vetëm “punon për përfundimin e çdo hapi të rëndësishëm hetimor të mbetur gjatë procedurës paraprake.”
3. ZPS-ja dhe paraardhësja e saj, Task Forca Hetimore Speciale (“TFHS”) i kanë hetuar pretendimet që përmban Raporti Parlamentar i Këshillit të Evropës i 7 janarit 2011, si dhe krimet e tjera të lidhura me ato pretendime që nga shtatori i vitit 2011. Faktikisht, që nga shtatori i vitit 2016, më shumë se katër vite më parë, ZPS-ja ka pasur mandat konkret për të kryer një varg veprimesh hetimore sipas nenit 35 të Ligjit për themelimin e DHSK-së dhe ZPS-së.⁵ Ndërsa Mbrojtja e rezervon plotësisht të drejtën për të kundërshtuar aspekte të ligjshmërisë së këtij ligji në kohën e përshtatshme, ZPS-ja dhe TFHS-ja kanë pasur kohë më shumë se të mjaftueshme për kryerjen e hetimeve të plota gjatë kësaj periudhe prej nëntëvjeçare. Rrjedhimisht, hetimet mund dhe duhej të kishin përfunduar para se të paraqitej për konfirmim nga ZPS-ja aktakuza kundër z. Selimi.
4. Gjithashtu, siç ka treguar përvoja e gjykatave të tjera ndërkombëtare, hetimet e mëtejshme nga Prokuroria në këtë fazë, së bashku me obligimet për nxjerrjen e

¹ *Prokurori k. Thaçit dhe të tjerëve.*, Urdhër i caktimit të datës për mbajtjen e konferencës mbi ecurinë e çështjes dhe për paraqitjen e parashtrimeve, KSC-BC-2020-06/F00074, 11 nëntor 2020, Publike (‘Urdhër për konferencën mbi ecurinë e çështjes’).

² *Prokurori k. Thaçit dhe të tjerëve.*, Shtojca 1 e Urdhrit për caktimin e datës për mbajtjen e konferencës mbi ecurinë e çështjes dhe për paraqitjen e parashtrimeve, KSC-BC-2020- 06/F00074/A01, 11 nëntor 2020, publike (‘Shtojca 1’)

³ Urdhër për konferencën mbi ecurinë e çështjes, KSC-BC-2020-06/F00074, para. 21(b).

⁴ *Prokurori k. Thaçit dhe të tjerëve.*, Parashtrimet e Prokurorisë për konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes, KSC-BC-2020-06/F00076, 13 nëntor 2020, para. 3 (‘Parashtrimet e ZPS-së’),

⁵ Ligji Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

materialit të mbledhur shpesh kanë qenë shkak për vonesa të shumta në procedurën paraprake dhe madje edhe gjatë gjykimit. Për këtë arsye, do të ishte e dobishme që Gjykatësit të Procedurës Paraprake, si dhe palëve e pjesëmarrësve të tjerë në këtë çështje t'u jepen përditësime, për të zvogëluar rrezikun e vonesave të tilla në mënyrë që t'i përmbahemi sugjerimit të ZPS-së se hetime të tilla të mëtejshme nuk do të “ndikojnë në kryerjen e shpejtë të procesit.”⁶

5. Për më tepër, për t'u siguruar se hetimet të mëtejshme nga ZPS-ja nuk do të shkaktojnë vonesa të tilla, do të jetë e domosdoshme që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të vlerësojë rreptësisht çdo kërkesë të ardhshme të ZPS-së për ndryshimin e listave të provave materiale dhe të dëshmitarëve në përputhje me rregullën 101(1)(b) për të shtuar dokumente dhe deklarata të dëshmitarëve pas datës së caktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, të cilat do të sigurohen si rezultat i këtyre hetimeve shtesë. Duke paralajmëruar tani se ndaj parashtrimeve të tilla do të merret qëndrim më i fortë, do të inkurajonte ZPS-në që të përfundojë hetimet sa më shpejt që është e mundshme.

2. Provat në posedim të Prokurorisë

6. Mbrojtja nuk bën parashtrime për këtë pikë.

3. Dëshmitarët në të cilët mbështetet ZPS-ja për aktakuzën dhe për gjykimin

7. Mbrojtja kërkon sqarime nga ZPS-ja për mospërputhjen në dukje midis informacionit të ofruar nga ZPS-ja se mbështetet në 153 dëshmitarë për Aktakuzën e Konfirmuar,⁷ ndërsa Gjykatësit të Procedurës Paraprake i janë dhënë vetëm 103 deklarata të dëshmitarëve.⁸
8. Gjithashtu, Mbrojtja vë në dukje parashtrimin e ZPS-së se parashikon të shtojë rreth 50 dëshmitarë të tjerë në listën e dëshmitarëve për gjykim. Siç është shpjeguar më lart, çdo kërkesë nga ZPS-ja për të shtuar më shumë dëshmitarë të tillë brenda afatit për dorëzimin e listës sipas rregullës 101(1)(b) duhet të vlerësohet rreptësisht nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake për të minimizuar rrezikun e vonesave në proces dhe për t'i

⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 3.

⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 5.

⁸ Parashtrimet e ZPS-së, tabela, para. 6.

mundësuar Mbrojtjes që të ushtrojë në mënyrë efektive të drejtën për t'u përgatitur në pajtim me nenin 21(4)(c) të Ligjit.

4. Hetimet e Mbrojtjes

9. Mbrojtja parashikon që do t'i duhet të kryejë hetime të gjera në këtë çështje.
10. Aktualisht, para nxjerrjes së materialit mbështetës të Aktakuzës, Mbrojtja nuk është në gjendje të japë hollësi në lidhje me kohëzgjatjen e hetimeve të tilla. Sidoqoftë, përvoja ka treguar se kjo kohëzgjatje varet nga faktorë të ndryshëm të radhitur më poshtë:
 - a. shpejtësia e nxjerrjes së materialit nga Prokuroria;
 - b. shkalla e redaktimeve të zbatuara në provat e Prokurorit, të atyre fajësuese si dhe të atyre shfajësuese;
 - c. plotësimi nga Prokuroria i obligimeve për nxjerrjen e provave dhe informacionit shfajësues, që është thelbësore për përgatitjen e mbrojtjes në mënyrë të shpejtë, tërësore dhe bashkëpunuese;
 - d. niveli i bashkëpunimit të shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe entiteteve të tjera me Mbrojtjen;
 - e. mundësia e anëtarëve të ekipeve mbrojtëse për të udhëtuar dhe kryer hetime konfidenciale gjatë pandemisë aktuale.

5. Njoftimi për alibi ose arsye të tjera për të përjashtuar përgjegjësinë penale

11. Mbrojtja nuk bën parashtrime për këtë pikë në këtë kohë, por do të përmbushë obligimet e veta në pajtim me rregullën 95(5) dhe 104(1)(a) në momentin e duhur sikurse kërkohet.

B. Materiali i rregullës 102(1)(a) (Materiali në mbështetje të Aktakuzës)

1. Sasia tërësore e materialit të rregullës 102(1)(a) dhe nxjerrja e hershme e materialeve të tilla

12. Nga përshkrimi i ZPS-së, Mbrojtja kupton se vëllimi i çështjes përmban rreth 34 herë më shumë faqe material se materiali i paraqitur nga Prokuroria në çështjen *Mustafa* sipas rregullës 102(1)(a).

13. Sidoqoftë, me gjithë këtë vëllim, Mbrojtja nuk e kupton se pse nuk ka qenë e mundshme që një pjesë e këtij materiali të nxirret para kalimit të afatit prej 30 ditësh të përcaktuar në këtë rregull. Nëse nuk kërkohen redaktime për një pjesë të këtij materiali, siç sugjeron Prokuroria,⁹ nuk ka arsye pse materiale të tilla të paredaktuara, më të paktën, nuk ka qenë e mundshme të nxirren para këtij afati. Prokuroria ka qenë më se e vetëdijshme për obligimet e veta për nxjerrjen e materialeve të tilla që kur e dorëzoi fillimisht Aktakuzën për konfirmim më 24 prill 2020 dhe sigurisht kur dorëzoi Aktakuzën e Rishikuar më 24 korrik 2020.¹⁰ Rrjedhimisht, përgatitjet do të duhej të ishin ndërmarrë që nga ajo datë për të siguruar nxjerrjen me kohë të informacionit në momentin e konfirmimit të Aktakuzës nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.
14. Gjithashtu, për arsye praktike, duke pasur parasysh mënyrën e nxjerrjes së informacionit përmes sistemit *Legal Workflow*, nxjerrja e njëhershme e të gjitha 1,842 provave që përmbajnë 43.108 faqe, si dhe shumë materiale video dhe audio, ka mundësi ta mbingarkojë sistemin. Nxjerrja e këtyre materialeve gjatë disa javëve, duke filluar me materialin e paredaktuar, do ta anashkalonte këtë problem.

2. Përkthimi i deklaratave të dëshmitarëve në gjuhën shqipe

15. Mbrojtja vë në dukje zotimin e Prokurorisë që përkthimi në gjuhën shqipe i të gjithë materialit në mbështetje të Aktakuzës do të përfundohet dhe të nxirret brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.¹¹ Nuk ka nevojë për parashtrime të tjera përderisa respektohet ky afat.

3. Redaktimi i materialit të rregullës 102(1)(a) dhe përmbledhjet e detajuara

16. Mbrojtja vë në dukje me shqetësim sugjerimet nga ZPS-ja se “redaktime të konsiderueshme janë të nevojshme si për materialet e rregullës 102(1)(a), ashtu edhe për përmbledhjen e detajuar të parashtruar sipas rregullës 86(3)(b).”¹² Ndërsa nuk vihet në dyshim se këto redaktime duhet të bëhen me kujdes dhe përputhshmëri me qëllim që të jenë të efektshme, siç sugjeron ZPS-ja, ritheksojmë se ZPS-ja duhej ta kishte filluar këtë proces njëkohësisht me paraqitjen e Aktakuzës dhe ta kishte përfunduar para

⁹ Parashtrimet e ZPS-së, paragrafët 7-8.

¹⁰ *Prokurori k. Thaçit dhe të tjerëve*, Publike, Versioni i redaktuar publik i fletarrestimit për Rexhep Selimin, 26 tetor 2020.

¹¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9.

¹² Parashtrimet e ZPS-së, para. 8.

paraqitjes së parë të z. Selimi. Gjithashtu, parashtrimet në lidhje me sistemin e redaktimit të propozuar nga Prokuroria janë përfshirë më poshtë.

17. Sa u përket përmbledhjeve të detajuara që i janë dhënë Gjykatësit të Procedurës Paraprake në përputhje me rregullën 86(3)(b), Mbrojtja vë në dukje se kjo dispozitë shënon përparim të konsiderueshëm në procesin e konfirmimit të aktakuzës të përdorur nga tribunalët *ad hoc*, të cilët nuk kanë pasur dispozitë të ngjashme.¹³
18. Ndërsa kjo dispozitë kryesisht ka për qëllim të ndihmojë Gjykatësin e Procedurës Paraprake në rishikimin e aktakuzës së dorëzuar, përmbledhja e detajuar gjithashtu shërben për t'i ndihmuar Mbrojtjes që të kuptojë akuzat dhe provat që pretendohet se i mbështesin ato. ZPS-ja duhej ta kishte përpiluar në atë mënyrë që të mundësonte nxjerrjen e paredaktuar të informacionit nëse do të ishte e mundshme. Rrjedhimisht, çdo redaktim i kërkuar për këtë dokument duhet të jetë sa më i kufizuar që të jetë e mundshme.

C. Materiali i rregullës 102(1)(b) (Materiali shtesë që synohet të përdoret në gjykim)

19. Mbrojtja vë në dukje synimin e ZPS-së për të nxjerrë të gjithë materialin e ardhshëm sipas rregullës 102(1)(b) deri më 31 maj 2021 ose, në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë para hapjes së çështjes nga ZPS-ja dhe se ky material përfshin 50 deklarata shtesë të dëshmitarëve dhe përafërsisht 1.500 prova materiale, përfshirë edhe ato të nxjerra sipas rregullës 102(1)(a). Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet se afati prej 30 ditësh para gjykitimit duhet të përdoret vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe Prokuroria duhet të japë arsye se pse nuk ka qenë e mundshme që materiali i rregullës 102(1)(b) të nxirret para kësaj date.
20. Në këtë aspekt, ZPS-ja nuk ka shpjeguar pse nuk mund të zotohet që të nxjerrë me herët materialin e rregullës 102(1)(b), për shembull atë që nuk ka nevojë për redaktim, para këtij afati.¹⁴ Nxjerrja e një materiali të tillë në momentin që është në dispozicion do të ndihmonte edhe Mbrojtjen edhe Gjykatësin e Procedurës Paraprake që të kuptojnë ato prova dhe do të mundësonte që çështjet që dalin nga ato të ngrihen dhe të shqyrtohen me kohë dhe në mënyrë efikase.

¹³ Shih p.sh. TPNJ rregulla 47.

¹⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 14.

21. Gjithashtu, për t'u siguruar se nuk do të ketë vonesa në gjykim, afati prej 30 ditësh para gjykimit për nxjerrjen e materialit të rregullës 102(1)(b) duhet të zbatohet për të gjitha provat që përfshihen brenda kësaj rregulle. Mbrojtja do të kundërshtojë fuqishëm çdo kërkesë për të vonuar nxjerrjen e informacionit përtej kësaj pike, për shkak të pasojave që do të kishte në përgatitjen e Mbrojtjes. Parashtrimet në lidhje me sistemin e redaktimit të këtyre materialeve janë dhënë më poshtë.

D. Materiali i rregullës 102(3) (Provat materiale për përgatitjen e Mbrojtjes, që i janë marrë ose i përkasin të akuzuarit)

22. Mbrojtja konsideron se nuk ka arsye që ZPS-ja nuk mund të kishte dhënë menjëherë provat që i janë marrë të akuzuarit, dhe më së voni brenda afatit për nxjerrjen e materialit sipas rregullës 102(1)(a), e jo deri më 30 prill 2021.

23. Sa i përket pjesës tjetër të materialit të kësaj dispozitë, Mbrojtja vë në dukje sasinë e madhe të materialit që mund të jetë i rëndësishëm e që përfshihet në këtë dispozitë, konkretisht 100.000 prova materiale sipas rregullës 102(3) dhe është e vetëdijshme për ekuilibrin e duhur që duhet të arrijnë ZPS-ja dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake për t'u siguruar se do të nxirren vetëm provat që janë me të vërtetë relevante, përkundrejt vëllimit më të madh të provave.¹⁵

24. Në këtë aspekt, ndërsa Prokuroria duhet të nxjerrë *proprio motu* materialin që beson se përfshin kjo rregull, ajo duhet t'u përgjigjet pa vonesë dhe në mënyrë transparente e efikase kërkesave për nxjerrje të informacionit në përputhje me këtë dispozitë, siç është parashtruar nga Mbrojtja. Këto kërkesa mund të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me fajësinë ose pafajësinë e të akuzuarve ose me mocionet e ndryshme procedurale që Mbrojtja synon t'i paraqesë në lidhje me dorëzarinë si dhe me juridiksionin e Dhomave të Specializuara. Në këtë aspekt, në përputhje me procedurat e përdorura para gjykatave ndërkombëtare të tjera, Mbrojtja kërkon nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ta urdhërojë Prokurorinë që t'i përgjigjet çdo kërkesë të Mbrojtjes për nxjerrje të materialit në përputhje me rregullën 102(3) ose 103 brenda një periudhe të përcaktuar, që Mbrojtja sugjeron se duhet të jetë tri ditë pune në çështjen aktuale, ose edhe me herët nëse natyra e kërkesës kërkon përgjigje më të shpejtë. Nëse ZPS-ja pajtohet me kërkesën e

¹⁵ Prokurori k. Salih Mustafës, Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështje përkatëse, 9 tetor 2020, para. 39 ("Vendimi kornizë").

Mbrojtjes për nxjerrje të materialit, atëherë materiali i kërkuar nga Mbrojtja nxirret brenda dy ditësh pune.

25. Për të lehtësuar rishikimin dhe analizimin e kësaj sasive të konsiderueshme provash, është jetike që materiali i nxjerrë sipas rregullës 102(3) të kategorizohet në mënyrë efektive dhe të nxirret përmes *Legal Workflow* në atë mënyrë që t'i mundësojë Mbrojtjes të kuptojë rëndësinë e tij dhe si rrjedhojë të përqendrohet në përgatitje.¹⁶ Kjo nevojë del në pah nga nevoja e deklaruar për redaktime të një përqindjeje të konsiderueshme të këtyre materialeve, siç shpjegohet nga Prokuroria¹⁷, që do ta bënte më të vështirë për ta kuptuar dhe analizuar materialin e nxjerrë.

E. Materiali i rregullës 103 (materiali shfajësues)

26. Mbrojtja vë në dukje ekzistencën e afërsisht 1.000 materialeve që mund të jenë shfajësuese e që do të nxirren jo më vonë se materialet në mbështetje të aktakuzës dhe se ZPS-ja e pranon obligimin e vazhdueshëm për rishikimin dhe nxjerrjen e materialit të rregullës 103 hap pas hapi.¹⁸ Nuk është e qartë nga parashtrimet e ZPS-së se a janë bërë redaktime në materialet tashmë të identifikuara. Çdo redaktim duhet të jetë sa më i kufizuar që të jetë e mundshme dhe Mbrojtja duhet të ketë të drejtë të njëmendtë që t'i kundërshtojë redaktime të tilla, siç është shpjeguar më poshtë.

27. Në pajtim me parashtrimet e lartpërmendura, Prokurorisë duhet t'i kërkohet që, kur të nxjerrë materiale të tilla, të shpjegojë për secilën provë pse konsiderohet shfajësuese duke iu referuar paragrafit të caktuar në Aktakuzë, dëshmitarit ose provave të tjera shkresore me të cilat ka lidhje.

28. Pretendimi i ZPS-së se duhet të lirohet nga obligimet në lidhje me nxjerrjen e materialit të rregullës 103 nëse ekzistenca e materialit shfajësues përkatës është e njohur dhe provat janë të disponueshme përmes ushtrimit të zellit të duhur, nuk është pa kufizime. Faktikisht, shembulli të cilit i referohet ZPS-ja, ai i nxjerrjes së Aktgjykimit në çështjen Haradinaj për mbrojtësin kryesor të mëparshëm të z. Haradinaj dhe për z. Krasniqi vlen vetëm për këta individë. Obligimet e ZPS-së mund të ndryshojnë në varësi nga situata individuale e secilit të akuzuar. Fakti se një i akuzuar ose mbrojtësi i tij kanë njohuri

¹⁶ Vendimi kornizë, para. 39.

¹⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 16.

¹⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 17.

për një informacion shfajësues nga një çështje e mëparshme nuk mund t'i vishet një të akuzuari tjetër dhe ekipit mbrojtës të tij që nuk i kanë këto njohuri.

29. Ngjashëm, çështjet që citohen nga ZPS-ja nuk e lirojnë atë nga obligimi për ta njoftuar Mbrojtjen për ekzistencën e materialit shfajësues dhe për t'i ofruar mjet përmes të cilit logjikisht pritet që Mbrojtja të mund të ketë qasje në të, “sa i përket materialit nga aktgjykimet e Tribunalit që nuk është publik ose për të cilin nuk ka referenca,”¹⁹ përfshirë Aktgjykimin *Haradinaj*, kur një informacion i tillë është nën ruajtjen ose kontrollin e ZPS-së, ose kur ajo ka dijeni faktike për të.

F. Materiali i rregullës 107 (materiali i mbrojtur)

30. Mbrojtja vë në dukje parashtrimet e ZPS-së në lidhje me materialin e rregullës 107 dhe se sigurimi i këtyre miratimeve do të vërë në rrezik afatet e njoftuara.

31. Sidoqoftë, siç është kërkuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ZPS-ja nuk ka dhënë hollësi nëse miratimet në fjalë:

- a. kanë lidhje me material të rregullës 102(2), ose të rregullës 103;²⁰
- b. është e nevojshme t'i paraqitet kërkesë Gjykatësit të Procedurës Paraprake për t'u liruar nga obligimi për nxjerrjen e materialit të këtyre rregullave;²¹
- c. nëse materiali i nxjerrë duhet redaktuar;²² dhe,
- d. nëse nevojiten masa kompensuese për materialin që nuk do të nxirret²³

32. Duke pasur parasysh mundësinë e mirënjohur për ndërprerje të shpeshta të procesit të shkaktuara nga vonesat në adresimin e këtyre pikave, duhet të jepen përgjigje të plota dhe të sinqerta në lidhje me to.

G. Procedura për nxjerrjen e materialit

33. Gjykatësi i Procedurës Paraprake është më se i vetëdijshëm se në vendimin kornizë të parë të nxjerrë në çështjen *Mustafa*, Prokuroria u urdhërua që të japë tabelën e detajuar të nxjerrjes së materialit, ngjashëm si përmbledhjen e detajuar që është dhënë për

¹⁹ *Prosecutor v. Gotovina et al.*, Decision on Ivan Cermak's Motion Requesting the Trial Chamber to Order the Prosecution to Disclose Rule 68 Material to the Defence, 7 August 2009, para. 12.

²⁰ Shtojca 1, para. 6(b)

²¹ Po aty, para. 6(d)

²² Po aty, para. 6(e)

²³ Po aty, para. 6(f).

materialin në mbështetje të aktakuzës sipas rregullës 86(3)(b), për të gjitha paketat e ardhshme të nxjerrjes së materialit fajësues të rregullës 102(1)(b) të Rregullores.²⁴ Vetëm pasi që ZPS-ja kërkoi rishikimin e këtij aspekti të vendimit kornizë, Mbrojtja në atë çështje dhe Prokuroria u pajtuan që të zvogëlojnë obligimin e rregullës 109(c) të Rregullores dhe vetëm të japin tabela përmbledhëse brenda një jave nga dita e dorëzimit të dosjes paraprake nga ZPS-ja.²⁵ Rrjedhimisht, Mbrojtja e kundërshton këtë aspekt të parashtrimeve të ZPS-së që të japë tabela të tillë të nxjerrjes së materialit pas një jave nga dita e dorëzimit të dosjes paraprake.²⁶

34. Duke pasur parasysh madhësinë e kësaj çështjeje në krahasim me çështjen *Mustafa*, dhënia e tabelave të tilla në vazhdimësi në të njëjtën kohë me dhënien e materialit të rregullës 102(1)(b), e jo të paraqitjes së dosjes paraprake të Prokurorisë në një të ardhme të largët, është e vetmja mënyrë për t'u siguruar që Mbrojtja do të jetë në gjendje të vlerësojë dhe analizojë në mënyrë të duhur materialin e nxjerrë. Ky kusht bëhet më i theksuar pas sugjerimeve të ZPS-së se do të kërkojë redaktime më të gjera të këtij materiali. Pa dhënien e tabelave të tilla të nxjerrjes së materialit nga ZPS-ja, kuptimi i rëndësisë së këtyre provave do të jetë edhe më i ndërlikuar.
35. Sa i përket formatit të tabelës së nxjerrjes së materialit, tabela e propozuar në çështjen *Mustafa*, në shikim të parë duket se nuk është e dobishme ose e përshtatshme në këtë çështje. Megjithatë, Mbrojtja pajtohet që ta diskutojë këtë çështje me Prokurorinë me qëllim që të arrihet një marrëveshjeje që siguron respektimin e plotë të rregullës 109(c). Meqenëse kjo çështje ka të bëjë me katër të akuzuar të ndryshëm, secili me pikëpamje dhe interesa të veçanta, këto diskutime me ZPS-në duhet të përfshijnë të gjitha ekipet, në mënyrë që të përpiqen për një zgjidhje që është e pranueshme për të gjithë.
36. Në këtë aspekt, Mbrojtja vë në dukje se *Legal Workflow* do të përdoret si mjet për nxjerrjen e informacionit në DHSK dhe ky sistem përmban zgjidhje teknike të ndryshme për regjistrimin dhe nxjerrjen e informacionit që kërkohet sipas rregullës 109(c). Si e tillë, kjo mundësi teknike duhet të formojë bazën për diskutim me

²⁴ Vendimi kornizë, para. 71.

²⁵ Vendimi për rishikim, Vendim, para. 23(c).

²⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 23 që i referohet Parashtrimin të përbashkët të tabelës për kategorizim sipas rregullës 109(c), miratuar në çështjen *Prokurori k. Salih Mustafës*, Vendim në lidhje me kërkesën e Prokurorit të Specializuar për rivlerësim ose leje për apelim, KSC-BC-2020-05/F00046, 5 nëntor 2020

Prokurorinë në lidhje me formatin e përshtatshëm për dhënien e tabelave të nxjerrjes së materialin të rregullës 101(2) si dhe për materialet e tjera të nxjerra.

H. Sistemi i redaktimit

37. Mbrojtja e kundërshton zbatimin e sistemit të redaktimit nga çështja *Mustafa* në këtë çështje, siç ka propozuar ZPS-ja.²⁷
38. Siç është pranuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në çështjen *Mustafa*, “nxjerrja e plotë e të gjithë materialeve dhe provave relevante është parim, ndërsa mosnxjerrja e informacionit është përjashtim” dhe çdo kufizim i nxjerrjes së plotë të informacionit duhet të jetë rreptësisht i domosdoshëm.²⁸ Sidoqoftë, përkundër këtij pranimi, sistemi i redaktimit që është vendosur në atë çështje, të cilin ZPS-ja e propozon të zbatohet në këtë çështje, i lejon të dy palët që të nxjerrin provat me “redaktime të zbatuara drejtpërdrejtë në kategoritë e informacionit të paracaktuara paraprakisht (“redaktimet standarde”) pa autorizim paraprak gjyqësor.”²⁹
39. Zbatimi i procedurës së çështjes *Mustafa* në këtë çështje do të bënte që barra e argumentimit të domosdoshmërisë së redaktimeve si përjashtim nga parimi i nxjerrjes së plotë të informacionit, të bartej nga ZPS-ja te Mbrojtja për të kërkuar heqjen e redaktimeve të vëna nga ZPS-ja pa mbikëqyrje gjyqësore. Ndërsa Mbrojtja nuk ka dyshim se ky sistem do ta bënte më të lehtë punën e ZPS-së, duke e liruar nga obligimi për paraqitjen e kërkesave për redaktime dhe arsyetimin për këto redaktime, është vështirë të shihet se si do të ishte kjo në pajtim me “respektimin e plotë të të drejtave të të akuzuarve” ose si “e shton aftësinë e paneleve gjyqësore në të gjitha fazat e procesit gjyqësor për të ushtruar në mënyre efektive dhe efikase mbikëqyrjen e procedurës së nxjerrjes së dokumenteve.”³⁰ Megjithëse sistemi i redaktimeve i miratuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vendimin kornizë parashikon vendim gjyqësor për çdo redaktim të kundërshtuar, ky nuk mund të kompensojë mjaftueshëm të drejtën për të bërë parashtrime në lidhje me redaktimet para se të zbatohen.
40. ZPS-ja propozon që t’i lejohej që të zbatojë redaktimet standarde pa autorizim gjyqësor në materiale të 108(1)(a), nenit 21(1) të Ligjit dhe rregullave 80(4)(a)(i)-(ii) dhe

²⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 24.

²⁸ Vendimi kornizë, para. 73.

²⁹ Vendimi kornizë, para. 78.

³⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para 25.

108(1)(b)-(c). Këto redaktime të propozuara mbulojnë një spektër të gjerë të informacionit që mund të jetë i dobishëm për hetimet e Mbrojtjes. Duke pasur parasysh obligimet profesionale për konfidencialitet që peshojnë mbi ekipet mbrojtëse, redaktime të tilla nuk justifikohen dhe do të rrezikonin që të vononin procesin gjyqësor.

41. Përkundër këtij kundërshtimi të redaktimeve *proprio motu* pa mbikëqyrje gjyqësore, Mbrojtja nuk e kundërshton në parim procedurën e përcaktuar në vendimin kornizë sipas të cilës kërkesat për redaktime jostandarde paraqiten njëherësh me deklarata të redaktuara të propozuara të dokumenteve së bashku me versionet e redaktuara të kërkesës.³¹ Kjo i mundëson Mbrojtjes që t'i rishikojë dhe analizojë dokumentet dhe deklaratat e redaktuara në pritje të vendimit në lidhje me kërkesën e ZPS-së për redaktime. Faktikisht, Mbrojtja nuk sheh asnjë arsye që e njëjta procedurë të mos zbatohet si për redaktimet standarde ashtu dhe jostandarde.

42. Në këtë aspekt, Mbrojtja nuk sugjeron se duhet të ndryshojnë kategoritë e redaktimeve, por vetëm se mbikëqyrja gjyqësore paraprake është e nevojshme për të gjitha redaktimet e kërkuara. Rrjedhimisht, çdo vonesë e shkaktuar me zbatimin në këtë çështje të regjimit të ndryshëm nga ai që është zbatuar në çështjen Mustafa do të ishte e kufizuar.

E paraqitur me respekt më 17 nëntor 2020,

/nënshkrimi/

Dejvid Jang

Kryembrojtësi i Rexhep Selimit

³¹ Vendimi kornizë, para 88.